

Brini

*“Fortesa e parë e një populli
asht’ atdhetarizma. Por kjo
fortesë ka për themel begatinë
kombëtare. E në një vend si
yni begatia asht’ BUJQËSIA”.*
Dr. Terenc Toçi

Botim i Drejtorisë së Bujqësisë, Pyjeve dhe Zhvillimit Rural, Bashkia Lezhë

Redaksia: Gjovalin Gjeloshi - Drejtor; Ermir Gjokhilaj - Redaktor përgjegjës; Hekuran Koka - Design; ☎ 0696262123, ✉ ermir_gjokhilaj@live.com

TOKA QË PO U KALBET “MISHI”, TOKA QË PO U DALIN “BRINJËT”

Dhe këtë tepri lagështie nuk mund ta shohesh nga dritaret e helikopterit, as nga kamera e televizionit dhe as me syzet e diellit të gazetarit. Atë “e sheh” vetëm këmba e atij që shkelë mbi sipërfaqen e parcelës, e sheh shpirti i atij që i dhemb për degradimin e tokës bujqësore



FAMILJE TË FORTA BLETËSH

Dimërimi i mirë i bletëve është kushti vendimtar për të mbajtur familje të forta bletësh e për të marrë rendimente të larta në prodhimet e bletarisë. Prandaj çdo bletar duhet të njohë e të zbatojë me korrektësi masat teknike për përgatitjen e zgjoit për dimërim.

» vijon, **FQ. 5**

KOHA PËR TË MBJELLUR...

Duhet të theksojmë se fermerët, tokat e të cilëve shtrihen në zona të rrezikuara nga lagështira e tepërt, aq më tepër në pikat kritike të përmbytjeve, duhet ta shmangin mbjelljen e grurit. Kurr mos të harrojmë se gruri kërkon tre gjëra: e para, kullim; e dyta, kullim dhe e treta, kullim.

» vijon, **FQ. 6**

MBRESA NGA ZELANDA E RE

Në vendin Waipoua dominojnë pyjet e ruajtura ashtu siç ishin në origjinën e tyre në Ishullin verior, me drurë “kauri”, që tash janë në mbrojtje të shtetit. Rruga me shumë kthesa dhe përgjatë saj pyjet e dendura anash, vetëm lart shihej një copë qielli. Edhe për një pemë të vetme, projektuesi i rrugës e ka ndryshuar drejtimin e saj. Por jo vetëm për një rrugë: asnjë projektues nuk guxon të projektojë për të ndërtuar në kurriz të ambientit, askush nuk guxon të këmbëjë një palat qoftë edhe me një pemë të vetme. Pema, pyjet, ato janë të parat.

» vijon, **FQ. 14**

Në brendësi...

Kalendari për muajin Tetor	4
“Bujqësia-çështje e të gjithëve”	4
Rezervuarët - një mundësi e shtuar	7
“Lara e Kallmetit”	8
Për 4 apo 14 vjet?	10
Hallet e bujqësisë sonë	11
Rajonalizimi i bujqësisë:	12
Pse nuk mbillet më... ..	13
Kontrolli i mishit apo i ujit	15

TOKA QË PO U KALBET "MISHI", TOKA QË PO U DALIN "BRINJËT"

GJOVALIN GJELOSHI

Toka është pasuria më e madhe kombëtare e çdo vendi. Është tërësia territoriale. Në fund të fundit, është vet ekzistenca kombëtare e një shteti në hartën e botës, janë trojet stërgjyshore. Nga ana tjetër, funksionet e tokës bujqësore janë të shumta dhe të pa zëvendësueshme. Nëse toka do të administrohet e përdoret sipas kriterëve shkencore, ajo do të ruante veti universale të prodhimit. Toka është mbajtësja e të gjithë aktivitetit tonë të përditshëm dhe burimi ynë i vetëm i ushqimit. Kjo "devizë" vlen për të gjithë popujt e globit, për ne shqiptarët edhe pak më tepër. Jemi vendi me më pak tokë bujqësore për frymë. Njëzet vitet e fundit kanë treguar se po e paksojmë çdo vit këtë normë dhe se jemi populli që po merremi më pak se çdo popull tjetër me tokën bujqësore.

Sipërfaqe të konsiderueshme të tokave bujqësore po degradohen nga kripëzimi ose pakësimi i lëndëve ushqyese dhe mungesa e lëndës organike. Shkaktari i parë i kripëzimit është uji i tepërt që gjendet në volumin e tokës bujqësore. Shkencërisht, një gram tokë mund të përmbajë dhjetra milionë baktere. Secili grup i këtyre mikroorganizmave jep kontributin e tij në riciklimin e lëndëve ushqyese dhe kimikateve të rëndë-

sishme në jetën biologjike të tokës. Në një tokë me terren të zhvilluar organik, zhvillimi i popullatës mikrobike është intensive dhe shoqërohet me përmirësimin e cilësive të shumta fizike të tokës. Gjithashtu përmirësohet struktura dhe qëndrueshmëria e agregateve strukturore, veçanërisht në kategoritë e tokave me strukturë ekstreme, si tokat ranore dhe të rënda argjilore. Në këto toka, me rritjen e popullatës mikrobike, përmirësohet poroziteti, ajrimi dhe kapaciteti ujëmbajtës i saj. Por nga ana tjetër, ky "gram tokë" nuk e luan më rolin e tokës bujqësore me veti prodhuese, nëse noton në një "gram ujë".

Të gjitha sa thamë më sipër, e të tjera e të tjera veti, përbëjnë atë që ne e përkufizojmë si tokë bujqësore me prodhimtari të lartë. Territori ynë është i vogël dhe me burime tokësore të kufizuara. Edhe pse kështu, degradimi i tokës po rritet. Pjesa më e madhe e ushqimeve, që mund të sigurohen nga prodhimi vendas, po vjen nga importi. Niveli i investimeve që shteti dhe shoqëria bën mbi tokën, ndikon direkt në mbrojtjen dhe rehabilitimin e burimeve tokësore, mbrojtjen e tokës nga erozioni dhe përmbytjet nëpërmjet përmirësimit të sistemit të kullimit dhe ujitjes, pyllëzime dhe prita malore, zgjerimi i kapaciteteve të hidrovoreve, ndërtimi i kanaleve për

priten e ujrave të larta etj.

Përveç detyrimeve që ka shteti nëpërmjet legjislacionit që prodhohet dhe zbatimit me korrektësi të tij, edhe vet pronarët e rinjë të tokave duhet të kontribuojnë e të investojnë mbi tokën. "Tokën nuk e ke trashëgim nga babai, thonë amerikanët, ia ke borxh djalit". Parë në këtë aspekt, pa dashur të kritikojmë ligjin e tokës të vitit 1991, që bëri pronarë të gjithë banorët që jetonin në fshatra e një pjesë edhe në qyteza, e shumica e tyre e mori tokën falas nga shteti, nuk do të thotë se, për një gjë të falur nuk duhet të kujdesesh. Është e vërtet se kur një mall e ke blerë me djersë e vlerëson më tepër, por toka nuk i përket vetëm këtij brezi. Toka është e të gjithë brezave dhe këto breza kudo që të jetojnë, do të ushqehen. Bujqësia fillon nga toka. Në vendin tonë, qeveritë e pas vitit 1990 vetëm sa kanë folur, se bujqësia është prioritet, por ato nuk e trajtuan asnjëherë si të tillë. Prioriteti kombëtar shpallet në platforma e programe qeveritare. Përcaktohen standarte e kriteret. Për bujqësinë, nëse do të ishte prioritet, objektivi i parë dhe themelor do të ishte mbrojtja dhe kujdesi ndaj tokës bujqësore. E para, mbrojtja si sipërfaqe fizike dhe pastaj kujdesi ndaj pjellorisë, mbrojtja nga "kalbëzimi" nëpërmjet vënies në punë të "arterieve" të largimit të ujrave

» vijon në fq. 3



Dukuri të erozionit në tokat kodrinore të Lezhës

» vijim nga fq. 2

të tepërta. Numri i popullsisë që banon në fshat vazhdon të mbetet përsëri në shifra të larta dhe nuk duket se hë për hë ka ndalur vërshimi drejt qyteteve i popullsisë rurale. Por nuk është vetëm ky shkaku, që duhet të mbrohet e pasurohet toka. Popullsia e një vendi, kudo që të jetojë do të ushqehet dhe ky ushqim vjen vetëm nga toka.

Tokat kërcënohen nga përmbytjet në sipërfaqe të shumta, veçanërisht në zonën fushore bregdetare, ku shtrihet shumica dërmuese e tokave më të mira që ka Shqipëria. Nga Shkodra e deri në Sarandë, duke përfshirë edhe Lezhën tonë me rreth 15 mijë ha nga 18 mijë hektarët e saj, shtrihet brezi më i mobiluar i tokave bujqësore, të kategorisë së parë deri në të katërtën ku prodhohet çdo bimë. Të gjithë kësaj sipërfaqeje pa përjashtim, po i kalbet "mishi" prej ujrave të tepërta të cilat prej vitesh nuk kullohen si duhet në pikpamje agronomike. Me tokën bujqësore ka vite që nuk merret "shkenca e tokës", por politika e institucioneve. Prej vitesh përmbytja e tokave trajtohet si emergjencë dhe jo si mungesë e theksuar e kujdesit ndaj tokës apo bujqësisë në tërësi. Edhe pse dihet se sa është sipërfaqja që përmbytet dhe ku shtrihen këto toka, shteti nuk merr e nuk zbaton masa paraprake. Emergjencë quhet një fatkeqësi që nuk e pret dhe jo një proces që e din se do të ndodhë sapo vjen stina e dimrit. Nga ana tjetër, nuk e përmend askush faktin e degradimit të tokave bujqësore për mungesë të theksuar të kullimit. Sistemi i kullimit pothuajse është braktisur edhe për shkak të shkatërrimit të sistemit të kanaleve të kullimit, të urbanizimit kaotik në tokat bujqësore, të fragmentimit të tokës në shkallë të lartë si dhe të mungesës së mirëmbajtjes të sistemit dhe infrastrukturës së kullimit të madh siç janë hidrovoret dhe kolektorët (kanalet e para kulluese).

Mirë, se gazetarët aq dinë dhe aq pyesin e shkruajnë, por edhe qeveritarët, edhe kryeministri e të gjithë flasin e propagandojnë masat antipërmbytje dhe as nuk pyet kush e as flet për masat që po merr Shqipëria për të kulluar tokat bujqësore fushore bregdetare. Këta, tw paditur pwr kwtw fushw, kujtojnë se, kur nuk shohin ujë mbi sipërfaqen e tokës, gjithshka e kemi në rregull, bujqësia nuk vuan, toka nuk lëngon, kur në të vërtetë ajo është duke dhënë shpirt. Sipas statistikave, rreth 40 mijë ha janë të rrezikuara për përmbytje, por ka dhjetë herë më tepër sipërfaqe, (rreth 400 mijë ha) që edhe pse mund të mos përmbytet, është

në të njëjtën gjendje: vuan nga lagështira e tepërt. Dhe këtë tepri lagështie nuk mund ta shohesh nga dritaret e helikoptetit, as nga kamera e televizionit dhe as me syzet e diellit të gazetarit. Atë "e sheh" vetëm këmba e atij që shkelë mbi sipërfaqen e parcelës, e sheh shpirti i atij që i dhemb për degradimin e tokës bujqësore dhe fëmija i atij që ushqehet me të ardhurat që merr prej asaj toke.

Erozioni është një nga format më të përhapura të degradimit të tokave kodrinore-malore kryesisht. Ai shkaktohet nga faktorët natyrorë dhe ndërhyrjet njerëzore. Është një proces gjeologjik, që përshpejtohet nga aktiviteti njerëzor. Erozioni ujon i tokës është forma më e përhapur kudo e veçanërisht në Shqipëri. Sipas të dhënave të publikuara, në disa pjesë të rajonit të Mesdheut, erozioni ka arritur një fazë të pakthyeshme. Shumë sipërfaqe toke në Shqipëri, hyjnë në këtë kategori. Erozioni ujon është më i përhapuri dhe prek sipërfaqen më të gjerë të territoreve. Mbulesa bimore është një nga masat më të rëndësishme për të kufizuar veprimin e erozionit. Veshja e tokave me bimësi, veçanërisht në zonat e larta të tokave pyjore, është mbrojtja më e mirë ndaj veprimit të erozionit. Sipas statistikave të botuara, para vitit 1990 në shkallë vendi, mbilleshin rreth 6 mijë ha pyllëzime të reja në vit, që ndikonin në mbrojtjen e tokës nga erozioni dhe ndërtoheshin rreth 60 mijë m³ prita malore që jo vetëm paksonin erozionin, por ndikonin edhe në mbrojtjen nga përmbytjet prej ujrave të larta. Tash 25 vite këto masa, por edhe të tjera që përmirësojnë e mbrojnë tokën bujqësore, realizohen në volume disa herë më të pakta, për të mos thënë shumë më të pakta. Sipas studimeve, në vendet ku pjerësia është më shumë se 25% dhe pa mbulesë bimore, humbja e tokës nga erozioni arrin ekstremet 120-180 ton/ha. Në zonën kodrinore-malore të Shqipërisë, nuk po vuajnë nga ky fenomen vetëm tokat bujqësore (arë), por edhe masivet kullosore e pyjore të cilat janë zhveshur nga bimësia. Tokave të tilla u kanë dalë "brinjët" sepse "mishi" u ka rrëshqitur në dete e lumenj.

A do të arrijë vendi ynë që të shpëtojë tokat fushore bregdetare nga lagështia e tepërt që po i kalbë ato dhe a do të mund të mbrojnë prej erozionit të pamëshirshëm qindra mijëra ha toka të tjera që po u mbesin vetëm "brinjët", si pamja e një kufome kur e eksplorojmë në varr pas disa vitesh.

MË SHUMË GAZETA TEK FERMERËT



NDOC VOCAJ
fermer
Shënkoll,
tregtar i
inputeve
bujqësore

I nderuar stafi i gazetës "Drini", ju përgëzoj shumë dhe ju uroj suksese të vazhdueshme për këtë gazetë të mrekullueshme që keni nxjerrë, e cila ka munguar prej vitesh. Gazeta po i ndihmon të gjithë fermerët dhe po u shërben si një specialist i mirë duke u dërguar atyre këshilla të vlefshme për bujqësinë.

Unë menaxhoj një farmaci bujqësore në Shënkoll dhe jam njohur me gazetën qysh në numrin e parë të saj. Gazeta botohet me sponsorizime të ndryshme dhe shpërndahet falas kryesisht për fermerët. Në këtë shpërndarje kam marrë pjesë edhe unë, sepse redaksia ka bashkëpunuar, siç jam njohur, me të gjitha farmacitë bujqësore apo pikat e shitjes së inputeve bujqësore etj, që ajo të shkojë drejtpërdrejt te fermeri i interesuar. Janë shtuar kërkesat për këtë gazetë, sepse në faqet e saj shkruhet për probleme që kanë interes vetëm për fushën e bujqësisë: njihet me rezultatet e Agjencisë së Kullimit mbi pastrimin e kanaleve kulluese, me punën e bërë për reabilitimin e sistemit të vaditjes, me gadishmërinë e specialistëve të kësaj drejtorie, për plehrat kimike të nevojshme, pesticidet që duhet të përdorin etj. Një vend të veçantë në gazetë zënë shkrimet për pyjet, blektorinë si dhe veçanërisht për bletarinë. Bletëritësit me këtë gazetë kanë një këshillues të përmuajshëm se si do të punojnë në familjet e bletëve etj. Lexuesi po njihet edhe me të dhëna statistikore, të cilat shërbejnë si matës të punës. Pra kjo gazetë po luan një rol të rëndësishëm në punën e çdo fermeri, prandaj duhen më shumë gazeta që të shkojnë tek ata.

KALENDARI I MBROJTJES SË BIMËVE PËR MUAJIN TETOR

PAULIN KOKAJ

specialist i mbrojtjes së bimëve në DBPZHR

Gjatë këtij muaji, fermerët që janë rigoroz në trajtimin e bimëve për të luftuar sëmundjet dhe dëmtuesit, në këtë muaj janë më të qetë, por jo të papunë. Ikin nga lista perimet e shumta të fushës, përveç ato të dimrit; shumica e pemëve frutore dhe bimë të tjera që mbarojnë ciklin. Por nga ana tjetër fillojnë të lashtat, fillon trajtimi kimik i farërave të grurit apo farërave të tjera që do të përdoren për hasëlle. Meqenëse këtë të fundit e kemi trajtuar në një shkrim të veçantë, po merremi vetëm me kulturat e mëposhtme.

ULLIRI

Kushtet ekoklimatike do të ndikojnë në rritjen e përçindjes së çeljes së vezëve të lëshuara nga miza e ullirit. Infeksioni i kokrrave mund të mbahet në kufinj të pranueshëm deri në 2-3% për ullinjtë e destinuar për konservim, ndërsa për ullinjtë e destinuar për vaj, lejohet infeksioni në vlerat 8-10%. Preparat ideal që mund të përdorim është insekticidi "Confidor 200 SL"



AGRUME

Gjatë këtij muaji pritet rritja e infeksionit nga tenja minuese e agrumeve dhe kryesisht infeksione të larta pritet në agrumet të cilat janë në kushte të ujitshme. Trajtimet kimike të realizohen të alternuara për të shmangur fenomenin e rezistencës. Preparatet që mund të përdorim për luftimin e tenjës minuese dhe njëkohësisht shmangien e rezistencës janë disa si, Calypso ose Avaunt.



DOMATE NË SERA

Si rezultat i lagështirës ajrore të lartë dhe i diferencave të temperaturave mes natës dhe ditës, do të vazhdojë të jetë present, si rezultat i kushteve të përshtatshme, vrugu dhe alternaria. Për kontrollin e tyre të realizohen trajtime kimike. Preparate që mund të përdorim në këto raste janë: Aliette, Antracol.



PRAS, HUDHRA, QEPË TË DYTA

Që në 10 ditoren e parë të muajit Shtator ka filluar dëmtimin miza e qepës (larvë në rrënjë) Prandaj ata fermerë që nuk kanë bërë trajtime para mbjelljes me preparat specifik për këta dëmtues, në këtë periudhë të bëjnë spërkatje. Preparate që mund të përdorim për luftimin e këtij dëmtuesi janë: Rogor ose Confidor.



"Bujqësia-çështje e të gjithë popullit" (Dhe detyrë angarie e disave)

700 gr bukë misri, 200 gr qumësht

"Bujqësia-çështje e të gjithëve", ishte shumë e përfolur gjatë regjimit komunist në Shqipëri, por asnjëherë nuk ishte e tillë. Bujqësia ishte pjesa më e diskriminuar. Prioritet kishte vetëm klasa punëtore që nxirrte nga thellësitë e tokës kromin, bakrin, arin, naftën, gazin etj.

Të gjitha këto u shërbenin pushtetarëve të regjimit. Asnjëherë kjo pasuri nuk i shërbeu bujqësisë dhe blektorisë. Bujqësia që në të vërtetë duhej të ishte çështje e të gjithëve, ishte vetëm çështje e asaj shtrëse që rëndom quhej fshatarësia kooperativiste, e cila kishte detyrimin të punonte pa asnjë ditë pushim, të prodhonte sa më shumë për klasën punëtore dhe gjithçka për pushtetin në fuqi, ajo vetë do të shijonte vetëm 700 gr. bukë misri për frymë dhe 200-500 gr. qumësht për familje. Këta do të quheshin bujkërobërit e shekullit të XX-të.

Qeveria dje, qeveria sot...

Njeriu nuk ushqehet me arin, me diamantin dhe me naftën që del nga thellësia e tokës 3000-6000 m, por ushqehet me ato produkte që natyra i krijoi në sipërfaqen e tokës deri në thellësinë 80 cm, të cilat i prodhon, i punon dhe tregton ajo pjesë e popullsisë që thirret bujqë dhe blegtorë. Të gjithë pushtetarët qeveritarë që nuk duan t'ia dinë se nga bjen ky sektor, kur ulen në tavolinën e ngrënies kërkojnë për herë të parë një sallatë domateje, që të parët tanë për vlerat që kishin i quajtën "molla të arta". Pas sallatës shijojnë mishin e pjekur në zgarë ose ngjallat e famshme të gjirit të Lalzit, të Kunes e Vainit tonë të Lezhës apo tavën e krapit të Shirokës në Shkodër.

Të gjitha këto të mira materiale për trupin e njeriut i prodhon Toka dhe uji nga dora e asaj pjese të popullsisë që gjithnjë e më pak po gëzojnë kujdesin dhe përkrahjen e qeverisë. Qeveria dje, vërtet e shfrytëzoi deri në palcë fshatarësinë kooperativiste, por të paktën e kishte vëmendjen te bujqësia e nuk bëhej fjalë për përmbytje, mungesë të kullimit apo të ujitjes. Bujqësia drejtohej me kompetencë nga specialistë të vërtetë. Sot edhe kryeministri e quajti para dy javësh, shtratin e lumit të Drinit "kanal kullues" dhe kujton se me dy kova eskavatori nuk do të ketë më përmbytje?! Vaj-medet në dorë të kujt ka rënë kjo punë...

Të nderuar pushtetarë që keni në dorë fatet e popullit, kthejeni kokën nga bujqësia, konsiderojeni bujqësinë si çështjen tuaj dhe çështjen e të gjithëve. Ulini taksat dhe tatimet për bujqësinë, uleni çmimin e naftës për punimin e tokave pasi çdo ulje do të ndikojë në rritjen e prodhimit e të cilësisë në produktet bujqësore dhe blegtorale të domosdoshme për njerëzit. Pasi të bëni këto, merreni atë ç'ka i takon Çezarit (juve) dhe atë ç'ka i takon Zotit lërjani bujqëve dhe blegtorëve, sepse Zoti atyre ua besoi tokën.


GEGË MILOTI

studjues, Lezhë

DIMËRIM I MIRË- FAMILJE TË FORTA BLETËSH

HILË HILA

Sektori i bujqësisë
në DBPZHR, Bashkia Lezhë



Dimërimi i mirë i bletëve është kushti vendimtar për të mbajtur familje të forta bletësh e për të marrë rendimente të larta në prodhimet e bletarisë. Prandaj çdo bletar duhet të njohë e të zbatojë me korrektësi masat teknike për përgatitjen e zgjoit për dimërim.

Nga mesi i vjeshtës, pasi pakësohet kullota në natyrë, vetë familjet e bletëve fillojnë përgatitjen e tyre për dimërim. Mëmat si kordinatore të punëve në zgjua pakësojnë pjelljen e vezëve deri në ndërprerjen e saj. Në familjet normale pakësohet numri i meshkujve duke i nxjerrë ato jashtë, fillon propolizimi i zgjojeve dhe zvogëlimi i dyerve (mbyllja me propolis). Ky është momenti ku bletari duhet të ndërhyjë në parkun e tij për përgatitjen e bletëve për dimër, gjithmonë sipas zonave dhe kullotës së pritshme.

Në fillim bëhet kontrolli paraprak i parkut duke mbajtur shënim mbi gjëndjen aktuale të tij si: numri i zgjoit, korniza në zgua, korniza me gjeneratë, sasia e mjaltit, mëma dhe gjendja e saj, vërejtje për riparime etj. Sipas zonave kur nuk pritët kullotë hiqen depot e mjaltit dhe sistemohen në vende të freskëta e të sigurta për t'u mbrojtur nga dëmtuesit



e ndryshëm gjatë dimrit. (Foto nr.1). Pasi depot sistemohen, mbyllën (hermetizohen) ruhen me 4-5 kokrra naltinë për çdo 2-5 depo të vendosura mbi njëra-tjetrën. Për ruajtjen e kornizave nga mola përdoret dhe djegia e leckave të njomura në sqfur çdo muaj. Në praktikë përdoret dhe ruajtja me fostoksinë, por është shumë e rrezikshme (vdekjeprurëse) për frymorët, pra don kushte të sigurta përdorimi i saj në ambiente të sigurta. Në botë sot ruhen kornizat me hoje në mënyrë të përsosur deri në përdorim në dhomat frigoriferike të qendrave të grumbullimit të mjaltit.

Shërbime të tjera që duhet të kryhen janë: ngushtimi i dyerëve për t'u mbrojtur nga sulmet e jashtme, të cilat shfaqen nga mungesa e kullotës; bëhen analizat e rezervës së mjaltit që mendohet për të dimëruar bletët me metodën e thjeshtë me alkol etilik 96 gradë. Kjo analizë mund të bëhet tek selia e shoqatës së bletarëve në Lezhë dhe shërbehet falas. (Foto nr.2). Në rast se mjalti nuk është cilësor hiqet dhe zëvendësohet me mjaltë cilësor ose sherbet sheqeri në raport 2 sheqer me 1 ujë. Në këtë periudhë zëvendësohen mëmat me defekte në park. Kjo dallohet kur në zgjua në këtë periudhë gjenden meshkuj me shumicë. Të gjitha këto shërbime në tërësi zgjasin rreth një muaj sipas zonave, më pas fillojnë ngricat dhe bletët mblidhen në tufën e dimrit dhe ky është momenti më i përshtatshëm për të bërë mbylljen përfundimtare të bletëve për dimër. Mbyllja përfundimtare e bletëve për dimër bëhet pasi të plotësohen tabelat me të dhënat e vërejtjet në kontrollin paraprak për një muaj rrjesht. Sipas vërejtjeve për çdo familje bëjmë kontrollin përfundimtar ku verifikojmë: gjëndjen e mëmës, pjellshmërinë, rezervat ushqimore të rregullta sipas normave jo më pak se 10 kg për zonën fushore dhe jo më pak se 15 kg për zonën malore, të sigurta për nga cilësia. Në këtë kohë familjet me më pak se 4-6 rrugë mizë duhen ngushtuar. Pasi u hiqen kornizat e pa mbuluara me mizë u vendoset jasteku ngrohës. (Fig nr. 3).



Familjet me 3 rrugë mizë e poshtë detyrimisht duhet të bashkohen për të dimëruar mirë. Bashkimi i familjeve të dobëta bëhet me njërin nga dy mënyrat: me letër gazete dhe me aromatizim kolonje, raki etj. Më me sukses në këtë periudhë bëhet bashkimi me letër gazete (Fig nr.4). Ky veprim konsiston në: heqjen e mëmës më të dobët të njerës familje, ku kornizat me mizë, pjellë e ushqim vendosen në depon e bletës që do bashkojmë, mbi të cilën më parë kemi vendosur mbi katin e parë një gazetë sipas figurës, (me gozhdë ose stilolaps gazetën e bëjmë me vrima). Mbi të vendosim katin me familjen pa mëmë të përgatitur më parë. Bletët e katit të sipërm kërkojnë të dalin jashtë dhe duke grisur gazetën gradualisht uniformizohen me aromën e mëmës së katit të parë dhe vetë familjen dhe bashkohen pa u dëmtuar. Pas 3-4 ditësh familjet kontrollohen dhe u hiqet kati i sipërm pasi është bërë bashkimi.

Me përfundimin e mbylljes së bletëve për dimër, sipas kushteve dhe normave të përmendura më lart, që afërsisht koinçidon në fund të muajit nëntor, bletari tashmë duhet t'i shikojë vetëm nga jashtë bletët, t'i lerë në qetësinë relative të tyre, t'i kontrollojë, që zgjojet të mos rrëzohen ose të mos u pikojë çatia etj.



KOHA PËR TË MBJELLUR...

Rritja e prodhimit kërkon zbatimin e kushteve agroteknike. Duhet të shmangim mbjelljen e grurit në zona të pagarantuara për përmbytjet

PAULIN KOKAJ

specialist i mbrojtjes së bimëve në DBPZHR

Fillimi i fushatës së mbjelljeve të vjeshtës ka ardhur. Fermerët duhet të përqëndrohen në rritjen e cilësisë së punimeve, përdorimin e dozave të nevojshme të plehrave kimike dhe përzgjedhjen e farave që të jenë sa më cilësore në rritjen e prodhimit. Për vetë kërkesat që ka gruri me një cikël 8 deri në 8,5 muaj, kërkon përkujdesje që në plugimin e parë, i cili duhet të jetë me thellësi 30-35 cm dhe me mbledhje kurriz peshku, në mënyrë që të krijohet mundësi kullimi më i përshtatshëm. Për vetë strukturat e tokave të rrethit tonë, të imponuara edhe nga reshjet e shumta të cilat janë karakteristike e zonave tona, rëndësi të veçantë ka edhe kullimi, hapja e vijave kulluese me thellësinë e duhur, gjë e cila ndikon edhe në luftimin e sëmundjeve të kalbëzimit të rrënjëve (Fuzarjозave). Një rëndësi të veçantë ka edhe përdorimi i plehrave kimike, bazë për rritjen e prodhimit. Në zonat e rrethit të Lezhës (sin ë të gjithë Shqipërinë) ka shumë kohë që nuk janë bërë analizat e tokës për të përcaktuar bilancin ushqimor të bimës, por megjithatë është e nevojshme për vetë kulturën, përdorimi i plehrave fosfatike përpara mbjelljes, duke përdorur 60% para plugut dhe 40% përpara frezës. Normat dhe llojet e plehrave kushtëzohen nga pjelloria e tokës. Është vërejtur se rezultate të mira ka dhënë përdorimi i superfosfatit në dozën 50-70 kg për dy, ku më rezultativ është superfosfati që ka dhënë lëndën minerale sqfur që ndihmon në zbërthimin e lëndës aktive të fosforit dhe asimilimin më të mirë të bimëve. Rezultate të mira ka dhënë në plehrimin bazë edhe përdorimi i NPK-ve me lëndë aktive azot, fosfor, kalium dhe me mikroelemente sqfur, zink apo bor. Normat e përdorimit të këtyre plehrave varrojnë duke parë edhe parabimën nga 20 deri në 25 kg për dy, kjo e përdorur para diskut ose frezës, për vetë prezencën e tre komponentëve ushqyes, plus mikroelementeve që përmbajnë. Ndërsa më rezultativ në rritjen e prodhimit është diamondi i

fosfatit me përqindje të lartë fosfori dhe azoti: përmbajtja e lëndëve aktive P₂O₅ me masën 46% dhe të azotit me 18%, bën që doza e përdorimit sipas cilësisë së tokës të variojë nga 18-22 kg për dy.

Në rritjen e prodhimit të grurit, tërshërës, elbit etj, një rëndësi të veçantë merr edhe qarkullimi bujqësor. Mbjellja grurë mbi grurë jo vetëm do të ulte prodhimin, por do ishte e rrezikshme edhe në zhvillimin e sëmundjeve të trashëgueshme nga kjo kulturë, siç janë: ndryshqet, fuzarjозat, urthi dhe bloza. Për këtë arsye parabimët më të mira do të ishin misri dhe perimet, bimë të cilat marrin në plehrimin e tyre bazë plehra organike, por dotë ishin edhe bimët bishtajore. Përdorimi i farave të zgjedhura është një tjetër faktor që ndikon në rritjen e prodhimit. Fillimi i mbjelljeve në rrethin tonë është nga 20 tetori, por në vartësi të kushteve klimatike shkon edhe deri në fund të dhjetorit. Synimi për të marrë sa më shumë prodhim, kërkon edhe një numër të plotë bimësh nga më e ulta 480-650 bimë për metër katrorë, gjë e cila realizohet në varësi edhe të fuqisë vëllazëruese të farës nga 22 kg/dy në muajn tetor, 25-27 kg në muajn nëntor dhe deri në 30 kg/dy në muajin dhjetor. Një domosdoshmëri tjetër është edhe përdorimi i farave të zgjedhura me prodhimtari të lartë dhe rezistente nga sëmundjet dhe dëmtuesit. Varietetet e grurit të përdorura që kanë dhënë rezultat në rrethin tonë dhe që kanë treguar rezistencë ndaj sëmundjeve janë: "Exotic", "Vittorio", "Toborzo", "Marsall", "Apache", "Suba" dhe "Ilirija". Prodhimtari të lartë jep edhe varieteti i grurit "Dajti", por vetia e tij delikate e shkundjes apo e dëmtimit nga zogjtë e bën më pak të kërkuar këtë varietet. Jo jashtë vëmendjes duhet lënë elementi kryesor që është përdorimi i farave të dezinfektuara me "Roxhil" apo preparate të tjera të destinuara për këtë proces. Përdorimi i farave të padezinfektuara do të sillte si rezultat shfaqjen e sëmundjeve të ndryshme si fuzarioza, ndryshku, bloza apo urthi, të cilat e ulin prodhimin deri në 60% sidomos në vite

me lagështirë të lartë. Shfaqja e dëmtuesve të tokës është tjetër problem që duhet pasur parasysh. Në kulturën e misrit janë vërejtur dëmtime nga krimbi tel apo krimbi i murrmë. Kjo e shfaqur në njësitë bashkiake Shënkoll dhe Balldre, në fshatrat Tale dhe Torovicë. Kjo kërkon dezinfektimin e tokës para mbjelljes me pyrimex apo preparate të tjera.

Krahas kulturës së grurit duhet theksuar se rrethi ynë është edhe një rreth blektoral për të cilën nuk duhen lënë pas dore edhe hasëllat e ndryshme, të cilat mbillen në këtë periudhë. Sipas strukturave të tokës mund të kultivohen hasëlla për kullotë të lirë, por edhe për të kositje për masë të njomë. Për vetë periudhën në të cilën mbillen na bën që me këtë kulturë të shfrytëzojmë edhe tokat e thata ranore apo inproduktive duke i stimuluar edhe me plehra kimike. Mirëpo për foragjerët që prodhojnë masë për tharje apo rrethime stallore kërkohen toka të mira dhe produktive. Përdorimi i foragjerëve në dimër zbut varfërinë e të ushqyerit të kafshëve, por edhe rrit prodhimin e qumështit. Nuk duhet lënë pas dore të ushqyerit e foragjereve me plehra fosfatike dhe azotike. Farat që mund të përdorim për foragjere në dimër dhe që japin masë të konsiderueshme për masë të gjelbër janë: tërshërë e kuqe, tërfil e lolium, të cilat mund të kombinohen edhe tërshërë me lolium me raport 17 kg tërshërë dhe 3 kg lolium, ose tërfil me lolium 3 kg tërfil dhe 3 kg lolium për dy. Siç e theksuam edhe më lart, i domosdoshëm është një kullim i mirë në mënyrë që të mos kemi pasoja në fazat e vllazërimit apo në shfaqjen e sëmundjeve të fuzariozave, ndryshqeve etj. Duhet të theksojmë se fermerët, tokat e të cilëve shtrihen në zona të rrezikuara nga lagështira e tepërt, aq më tepër në pikat kritike të përmbytjeve, duhet ta shmangin mbjelljen e grurit. Le të shfrytëzojnë atë pjesë të sipërfaqes (nëse tokën e kanë në dy-tre vende) që e kanë disi të mbrojtur nga uji i tepërt. Kurr mos të harrojmë se gruri kërkon tre gjëra: e para, kullim; e dyta, kullim dhe e treta, kullim.

Rezervuarët - një mundësi e shtuar për rritjen e sipërfaqes së tokës nën ujë

Në periudhën e tanishme kujdesi duhet treguar te digat e tyre

ZEF MICI
RROK PALI

Inspektorë të ujitjes në DBPZHR

Deri në vitin 1990, sipas të dhënave statistike që disponohen, aftësia ujitëse në shkallë kombëtare ishte rreth 60 përqind e sipërfaqes së tokës së punuar. Kjo shifër erdhi duke u reduktuar pas këtij viti, aq sa në vitin 2010 u regjistrua vetëm 29 përqind e tokës që ishte nën ujë. Sipas qarqeve kjo shifër shkante 19-39 përqind. Po të zbresim në nivel rrethi (bashkie), Lezha

m3 dhe sipërfaqe ujitëse prej 150 ha; rezervuari i Troshanit me një kapacitet 60.000 m3 dhe sipërfaqe ujitëse prej 70 ha; rezervuari i Kashnjetit me një kapacitet 428.000 m3 dhe sipërfaqe ujitëse prej 160 ha dhe rezervuari Patalej me një kapacitet 110.000 m3 dhe sipërfaqe ujitëse prej 30 ha. Këto ishin vepra të rëndësishme që ndikojnë në shtimin e sipërfaqes së tokës së vënë nën ujë. Gjatë këtyre viteve edhe pse nuk është treguar ndonjë kujdes ndaj tyre, ato nuk janë të

degraduara dhe e kanë ruajtur funksionin e tyre.

Por si është gjendja aktuale e tyre sot? Drejtoria e BPZHR me një grup pune inspektoi nga afër gjendjen e këtyre objekteve, në këtë fazë jo si objekte të destinuara të ujitjes, por si vepra hidrike, të cilat duhet të trajtohen me kujdesin e objekteve në përbërje të të cilave janë digat.

Nga ana e vet edhe Ministria e Brendshme kërkon nga pushteti vendot relacion mbi gjendjen e digave të rezervuarëve, prej dëmtimit të të cilave në kohë reshesh, mund të na shkaktohen fenomene të përmbytjeve të pjesshme.

Sipas verifikimeve të kryera në terren, grupi i punës konstatoi se gjatë viteve të fundit është ndërhyrë pjesërisht në mirëmbajtjen e digave, (natyrisht as që bëhet fjalë që rezervuarët të kenë ruajtur kapacitetin e ujëmbajtjes në kohën kur janë ndërtuar). Në përgjithësi digat e të pesë rezervuarëve kanë probleme të mbaritura, por kjo nuk do të thotë se ndonjëra prej tyre mund të rrezikojë prishjen apo çarjen e pjesshme dhe të shkaktojë përmbytje. Nga kontrolli që ushtruan konstatuam që të gjitha digat janë të veshura me shkurre dhe pemë, gjë që janë një rrezik më vete për dëmtimin e tyre. Duhet të ndërhyhet për pastrimin dhe eliminimin e tyre, sepse rrënjët e pemëve dëmtojnë

monolitetin e përbërjes së digës. Pothuajse të gjitha digat për gjatë kurorave të tyre kanë krijuar të çara të vogla që nesër nëse nuk ndërhyhet për riparimin e tyre, mund të bëhen të mëdha e për pasojë mund të sjellin rrezikimin e rezervuarëve Kallmet dhe Kashnjet. Diga e rezervuarit të Kallmetit, në pjesën qendrore nga ana e jashtme e argjinaturës ka 3-4 rrjedhje uji (burime) dhe si pasojë rrëshqitje dhe. Më problematik në këtë rezervuar mbetet mosfunksionimi i shkarkuesit fundor, i cili për herë të fundit është hapur në vitin 1992. Ky shkarkues, nga ana e brendshme e digës (në fundin e saj), nuk duket fare. Përveç kësaj është i mbushur me inerte dhe mbetje plastike të hedhura pa kriter nga banorët e zonës. Shkarkuesi i tepricave është i rregullt, por ka probleme edhe në sistemin vaditës: njëra ndër dy saraçineskat e shkarkuesit të vaditjes është jashtë funksionit. Probleme paraqet edhe diga e rezervuarit Kashnjet. Terreni ku është ndërtuar ky rezervuar është malor dhe për pasojë krijohen probleme më të mëdha nga prurjet e shumta që vijnë gjatë stinëve të vitit. Pothuajse e gjithë kurora e digës nga ana e brendshme ka gërryerje (ka krijuar prroska të vogla). Diga nga ana e brendshme është e veshur me gurë dhe si pasojë e këtyre gërryerjeve ka nevojë për ndërhyrje. Ka dy shkarkues të tepricave, njëri është në pjesën lindore të digës dhe është i mbyllur plotësisht, kurse tjetri në anën perëndimore është në rregull. Por në distancën 60 m nga dalja e rezervuarit ka pasur çarje të kanalit dhe ujrut që shkarkohen rrezikojnë digën nga jashtë sepse krijon gërryerje. Kjo çarje është mbyllur, por për siguri ka nevojë për ndërhyrje. Shkarkuesi fundor funksionon normalisht.

Me më pak probleme janë tre rezervuarët e tjerë përsa i takon gjendjes së digave. Por për të qenë sa më funksional dhe t'i shërbejnë qëllimit për të cilin janë ndërtuar, duhet të ndërhyhet me investime për të bërë rehabilitimin e tyre. Ne kemi përgatitur edhe një preventiv për këtë qëllim dhe vitin që vjen bashkia do të parashikojë fonde për riparimin e tyre, si të digave ashtu edhe të përmirësimit të kapacitetit ujëmbajtës, por edhe të aksesoreve të sistemit të ujitjes.



Pamje nga rezervuari i Kashnjetit

në vitin 1990 kishte nën ujë 95 përqind të sipërfës së tokës së punuar ose e shprehur ndryshe, 17.5 mijë ha. Përjashtojmë Troshnjën që ujitje 90 përqind të sipërfaqes ose 6700 ha, rrethet e tjera ujisnin 26-75 përqind të sipërfaqes së tokës së punuar. Me fjalë të tjera, bujqësia e Lezhës ishte më e privileguara përsa i përket sipërfaqes që ujitet. Në Lezhë aplikoheshin të gjitha llojet e ujitjes: me rrjedhje të lirë e me ngritje mekanike si dhe "megaujitja" në formë shiu tashmë e shkatërruar, e ish-kënetës së Kakarriqit në një sipërfaqe prej 2200 ha.

Një burim tjetër i ujitjes në rrethin e Lezhës kanë qenë ujëmbledhësit (rezervuarët) apo liqenet artificial të krijuar në fund të pjerrësive të shpateve malore apo të masiveve të kodrave. Në rrethin e Lezhës kanë qenë dhe janë në funksion pesë rezervuarë të tillë: rezervuari i Kallmetit me një kapacitet 2.440.000 m3 dhe sipërfaqe ujitëse prej 700 ha; rezervuari i Fishtës me një kapacitet 443.000

"LARA E KALLMETIT" RACA MË

Prof.As. Dr. XHEVDET BASHLLARI
Zooteknik ATIF DEMA



Dhi të racës "Lara e Kallmetit"

Një gojdhënë.

Është trashëguar nga brezi në brez dhe ka mbërritur në ditët tona: një kallmetas kishte tufën më të mbarë në gjithë zonën; jo vetëm si numër, por edhe çdo kokë dhi po ta shikoje, të kënaqej syri. Ishte një racë e veçantë që nuk e kishin të tjerët. Për ushqim, beharit kishte boll kullotë, malit të Velës dhe tutje vargmalin, por zor ishte dimrit. Në të hyrë të vjeshtës, vinte fushata e prerjes dhe vënies së dushkut për dimër. Si çdo vit, në fushatë thërrisnin miq e shokë për ndihmë.

Një ndër argatët, që e kishte parë tufën e dhive dhe ia kishte vënë syrin sojit të dhive laramane gjithë ditës, kishte punuar së bashku me të zotin e tyre. Në të perënduar të diellit, i zoti i dhive sipër, duke vendosur e ngjeshur degët me gjethe të thara, përreth trungut të drejt të lisit, ndërsa argati nga poshtë e furnizonte me ndihmën e furkës. Erdhi fundi. Argati nga poshtë, pas palës së fundit, si zakonisht i dha edhe një drunë, në formë të shkronjë "v" për t'i mbyllur majën e lisnikut (mullari me degë e gjethe lisi). Si zakonisht, nga maja e lisnikut i kërkoi argatit poshtë, t'i jepte litarin për të zbr-

tur. (Bëhet litar i më dysh, kalohet nëpër trungun e lisit dhe duke mbajtur dy skajet e litarit zbrer, në tokë). Por argati nga poshtë, me litar në dorë, iu drejtua atij në majë të lisnikut:

-Nuk ta jap, po nuk më dhe fjalën, që të më japish një cja, për ndërzimin e dhive të mija. Dua të marr sojin e dhive lara në tufën time. ..

U zu ngushtë i zoti i tufës së dhive. Dy burrat shkëmbyen fjalë, deri sa u dha fjala. Kështu, doli jashtë tufës soji i mirë i dhive "Lara e Kallmetit".

Dy fjalë për një konkurs.

Ishte shtatori 2007. Dy specialistë nga Ministria e Bujqësisë, autorë të shkrimit, ideuan, drejtuan dhe realizuan në Kukës, konkursin dhe panairin kombëtar, madje edhe ndërkombëtar, sepse kishte pjesëmarrës edhe jashtë kufijve shtetëror, por ama përsëri midis shqiptarëve. Në të, morën pjesë blegtorë fitues të konkurseve në zonat, këtej dhe andej pa dallim kufirin, nga Kosova, Maqedonia dhe Mali i Zi. Konkretisht: delen "Rudë" e sollën, sipas kritereve të konkursit, (10

Nr	Fermeri	Dhi pëlleja krerë	Pjelloria %	Rendimenti i qumështit litër/kokë	Pesha e kecit në shkëputje-60 ditë/kg
1	Zef Matia	150	97	130	20
2	Frok Bardhoci	100	96	120	18
3	Ndue Bardhoci	150	95	120	18
4	Zef Nikolla	80	93	115	16
5	Tom Jaku	100	95	115	18
6	Gjon Jaku	100	94	116	18
7	Sokol Biba	150	92	110	18
8	Gjergj Frroku	60	90	110	16
	Shuma	890			

E BUKUR E DHIVE NË BALLKAN


dele dhe një dash) fituesit e qarkut të Kukësit, blegtorët e Grykës së Çajës, po Racën "Rudë" e sollën edhe fituesit e konkursit në Kosovë; po kështu lopë të racës "Iliria" e "Busha" e sollën për Shqipërinë, fituesit e zonës së Kukësit, por edhe fituesit e konkursit në Kosovë; kështu, është edhe raca e deleve "Shkodrane" në Shkodër, po edhe në vazhdim, në zonën e Tuzit të Malit të Zi. Në konkurs erdhën blegtorë, përpunues me nënprodhimet e qumështit (djathëra karakteristike të zonave përkatëse dhe artizanë të qilimave, përpunues të leshit me punimet artizane), veshje të kostumeve tradicionale (qeleshe etj). Këtej dhe andej kufirit morën pjesë specialistë blegtorie, pedagogë të Universiteteve të Bujqësisë nga Tirana e Prishtina dhe pushtetarë të lartë nga Shqipëria e Kosova. Në ditën e parë, u zhvillua sesioni shkencor me temë: Racat autoktone dhe vlera ekonomike e tyre.

Ditën e dytë, komisioni i konkursit shpalli fituesit e fituesve. Ai konkurs, hyri në historinë e zhvillimit të racave autoktone. Nga qarku i Lezhës, fitues në konkurs, dolën fitues për racat e dhëve, blegtori më i moshuar Gjeto Kola, me delet e racës "Balusha" dhe për të dhirtat blegtori Zef Matia me dhitë e racës "Lara e Kallmetit".

Pas përfundimit të konkursit, dy specialistët i kërkuan Ministrin të Bujqësisë që të jepen grande, për të nxitur shtimin e numrit të krerëve, sipas përvojës së shteteve fqinjë: Greqia, jep shpërblim për çdo kokë të shtuar; p sh një blegtor ka 100 krerë, në fillim të vitit, nëse në fund të vitit, arrin 130, jep shpërblim të veçantë për 30 krerë; Në Maqedoni, jepet shpërblim për çdo qengj apo kec të lindur. Propozimi jonë ishte: Për të nxitur ruajtjen dhe mbarështimin e racave autoktone, të jepen për çdo qengj e kec të lindur, por për racat autoktone të jepet shpërblim i veçantë, mbi atë të kecape e qengjave të racave të tjera.

Raca "Lara e Kallmetit" është dhia më bukur dhe më tërheqëse në Ballkan e më gjerë. Pjesën e shpatullave, qafën e deri te edhe veshët i ka të mbuluar me "shall", në ngjyrë të zezë; ka të bardhë, të pa mbuluar nga "shalli i zi" vetëm një pjesë të fytyrës, ballin dhe hundën. Mesin, kurrizin dhe barkun e ka të bardhë, ndërsa pjesën e vitheve dhe të këmbëve të prapme i ka mbuluar me ngjyrë të zezë. Qafën e ka të gjatë, që ja shton edhe më tej elegancën. Këmbët të drejta e të gjata, me thundra të bardha e të forta, që i vendos e sigurt në të përpjetën e tatëpjetën e malit të Velës e vargmalit në krah të tij.

Lartësia në xhidavi te dhitë shkon 65-75 cm, ndërsa te meshkujt shkon 75-80 cm. Gjatësi e trupit te dhitë 70-75, ndërsa te cjeptë 80-85. Thellësia e gjoksit te dhia 50-55, ndërsa te cjapi 55-60 cm. Perimetri i gjoksit te femrat e rritura shkon 85-90 cm, ndërsa te meshkujt 90-95cm. Për prodhimtarinë po japim si shembull rezultatet e tufave sipas barinjve, për vitin 2007.



Bariu Zef Matia nga Kallmeti me cjamin e racës "Lara e Kallmetit"



Autorët e shkrimit në mes të kopesë së dhivë të kësaj race

PËR 4 APO 14 VJET?

-Në të vërtetë Agjensia e Kullimit në DBPZHR të Bashkisë, nuk po pastron kanale, por për volumet e punës që kryen, po hapë kanale të reja kulluese. Në këto kushte nuk mund të ketë ritme të tjera me mjetet që kemi në dispozicion.

-Është e dhimbshme kur pastrimin e kanaleve kulluese e pengojnë vetë fermerët dhe nuk e kuptojnë se dheu që del prej fundit të atyre kanaleve është ajka e tokës së tij.

JAK FRANI

kryetopograf në

Agjensinë e Kullimit e Ujitjes

Një shprehje e popullit thotë: "sa më shumë që të punosh, aq më shumë do të të kërkojnë punë". Nga fillimi i muajit të kaluar, pamë në ekranet e televizioneve fermerë nga Torovica e Malecajt që flisnin mirë për punën me cilësi që po bëhej në hapjen e kanaleve kulluese të dyta, por edhe që kërkonin ritme më të larta. Madje një prej fermerëve të Torovicës i shkruante një sms kryetarit të Bashkisë ku i kujtonte se "me ritmet që po punohet në pastrimin e kanaleve kulluese, për me e realizue objektivin nuk do të mjaftonin as 14 vjet e jo më katër sa është mandati".

Puna e Agjensisë së Kullimit është përqëndruar kryesisht në zonën e ish-kënetës së Kakarriqit, në zonën e Ball-drenit, Torovicës e Malecajve. Por nuk janë lënë jashtë vëmendjes edhe sektorë të tjerë si në Blinisht, Spiten, Ishull Shëngjin, Lalm, Gocaj etj. Kryesisht në ato pika që janë më të prekura si ultësira. Është një punë që nuk është kryer për 25 e më shumë vite. Ka kanale të dyta kulluese, sidomos në Malecaj e Torovicë që janë rrafshuar me tokën. Madje më

poshtë me nivel është rruga bri tyre se sa fundi i kanalit. Në këto kushte sasia e dherave që gërmojnë eskavatorët është e pallogaritshme në asnjë preventiv. Dokumentacioni i përgatitur nga studio private dhe të pajtuara nga ministria e bujqësisë nuk i përgjigjet në asnjë rast sasisë së dherave që pastrohen kanalet. Është qesharake të përllogaritësh për pastrim vetëm 15-20 cm dhë në fund të kanalit, sikur ne do ta pastrojmë kanalim me lopatë, kur kova e eskavatorit është përllogaritur që të nxjerrë një volum prej 0.5-0.75 të metrit kub. Në këto raste teknika topografike nuk e llogaritë që të pastrohen kanalet. Në shumë raste ne nuk po pastrojmë kanalet e dyta, por po bëjmë kanale të reja, aq të mbushura me dhë janë.

Po t'i rikthehemi ritmeve të punimeve, kush më shumë se sa ne që jemi në krye të këtyre punëve, do të dëshironte ritme më të larta? Askush më shumë se sa ne nuk do të dëshironte që brenda këtij viti, së paku i gjithë volumi i kanaleve të dyta kulluese që kanë nevojë për ndërhyrje emergjente, të ishin të gërmuara e të pastruara në kuotën e kërkuar. Por kjo megjithë dëshirën tonë, edhe të fermerëve domosdo, nuk mund të realizohet. Është e vërtetë se puna e 25 viteve nuk

bëhet në një vit edhe po të keshë me bollëk mjete e karburant, por as edhe në katër vjet. Ah po, në 14 vjet bëhet, por me punë të përvitshme dhe me këto ritme që po kemi, ajo punë bëhet dhe do të bëhet shumë më shpejt. E kemi thënë edhe herë tjetër: megjithë fondet dhe mjetet e transferuara nga ministria e bujqësisë, ato janë krejt të


pamjaftueshme për t'u bërë ballë deficiteve që janë transferuar nga viti në vit. Punët e 25 viteve së paku bëhen për 25 vjet, shtu këtu edhe detyrat e viteve në vijimësi.

Nganjëherë ritmet e punës ngadalësohen edhe nga pengesat që nxjerrin vet fermerët. Është e paimagjinueshme të ketë fermerë që të kundërshtojnë hapjen e kanaleve e aq më tepër të pengojnë punën, me justifikimin se "nuk duhet të hedhim dheun e gërmuar në parcelën përbri". Në disa raste na është dashur të kërkojmë edhe ndihmën e policisë për të ndërhyrë tek persona të veçantë që nuk kemi gjetur mirëkuptim. Në vend që të na ndihmojnë në prerjen e pemëve që ata vet i kanë mbjellur në fundet e kanaleve jashtë çdo rregulli apo prerjen e bimësisë tjetër të rritur e të bërë pyll prej viteve të shumta që kanë kaluar pa ndërhyrje, fermerët kundërshtojnë hedhjen e dheut që pastrohet prej kanalit kullues në ngastrën e tyre. Kanali kullues, i dytë apo i tretë, i shërben kullimit të tokës së fermerit. Dheu që përftohet prej pastrimit është i asaj parcele, i atij blloku ngastrash. Cili bujk nuk e din këtë gjë? Cili bujk nuk e din se ajo sasi dheu që del nga pastrimi, përbën tokën më të mirë, më prodhimtare? Edhe nëse dikush do të kërkonte që t'ia merrte këtë sasi dheu, vet bujku duhet të kundërshtonte dhe të thërriste me të madhe: ju po më merrni ajkën e tokës! Çdo bujk, nëse është i tillë dhe e njuh bujqësinë e shikon çdo vit se bimët që ai mbjellë në tokën e tij, janë më të shëndetshme në krye të parcelës, aty ku vazhdimisht është shpërndarë dheu që ka dalë nga pastrimi i kanaleve kulluese. Gjykuar kështu, ne fermerët duhet të jemi të parët të interesuar që jo vetëm të pastrojmë e thellojmë kanalet kulluese, por edhe t'i kthejmë tokës atë sasi dheu të çmuar që nëpërmjet erozionit të vet ngastrës në vite, ka përfunduar në kanalim kufizues të kullimit.



Kanal i dytë kullues i hapur në Malecaj

HALLET E BUJQËSISË SONË



TAJAR ZAVALANI
Marrë nga
revista
"Bota e Re",
Korçë 1936

Shkolla e bujqësisë në Kavajë kërkonte nxënës. Një profesor i saj shkoi nëpër katundet për të rekrutuar djem bujqësh. Katundarët e pyetën se ç'punë do të bënin djemtë e tyre mbasi të mbaronin shkollën. Profeshori djalosh iu përgjigj se do të ktheheshin në shtëpitë e tyre dhe do të lëvrinin tokën duke përdorur metodat e bujqësisë moderne. Katundarët u skandalizuan, e quajtën këtë gati një të fyeme dhe iu përgjigjën: "Na thoni (allahil) a ka ndonjë shkollë që t'i sigurojë çunit një rrogë të shtetit, se sa për të lëvruar tokën ne s'kemi nevojë të stërvitemi nëpër shkolla. Atë punë e dimë ne vetë më mirë se ju."

Ky është mentaliteti i vjetër në shpirtin e bujkut shqiptar. Djali po mbaroi shkollën më të vogël bëhet i kalemit dhe atëherë s'i ka më hije të qëndrojë në katund dhe të mbajë parmendën. Ai duhet medoemos të turret në qytet e të zërë punë në qeveri. Kjo mendësi i ka rrënjët në gjendjen e vajtueshme ku ka arrirë bujqësia ndër ne. Kur mbajmë fjalime dhe shkruajmë artikuj ne nuk lëmë rast të kalojë pa theksuar se bujqësia është burimi kryesor i jetës sonë ekonomike. Dhe kjo nuk është një frazë e zbrazët. Po ashtu si punohet sot toka ndër ne bujqësia është në dekadencë dhe bashkë me të po shkatërrohet baza e ndërtesës sonë shoqërore. Bujqësia, në vend që të jetë puna më e sigurtë, më e qëndrueshme dhe me gëzim prurëse është bërë një skëterrë, një burim vuajtjesh pa ilaç për katundarin tonë. Nuk e kemi fjalën në rrebeshet e natyrës, (shi, breshër, përmytje, thatësirë) me të cilët bujku ynë është në luftë orë e çast. Jo, atij sot i janë shtuar një tok andralla të tjera të lindura nga kriza ekonomike dhe për të cilat fajin s'ia ka më natyra

po njerëzit, dua të them "vëllezërit" e tij të qytetit. Kështu bujku ynë ka aritur ta quajë një fatkeqësi qëndrimin në katund. Puna e tokës s'e ushqen më; taksat e shtetit, fajdexhinë, tregtarin s'ka me se t'i paguajë, lekun ai nuk e sheh më me sy. Në horizont nuk duket asnjë rreze drite, asnjë shpresë përmirësimi. Prandaj katundari gjuan rastin të lërë kasollen e tij dhe të zërë punë në qytet. Katundi shqiptar po ç'popullësohet. Qytetet po mbushen me dy lloj proletarësh. Ata të shkuarit nga mosha, që vijnë shpesh herë me gra dhe kalamaj të reckosur e të cflitur; dhe djemtë e tyre me kravata që sillen nëpër rrugët në pritje të ndonjë pune që s'vjen kurrë.

Ky ç'popullsim i katundeve është plaga jonë e madhe. Shteti ynë i ngjet atij që prët degën ku ka hipur. Me taksat që ka vënë substanca e bujqësisë pompohet në favor të elementeve parazitë të qytetit dhe nuk i kthehet më. Bujqësisë po i thithet palca dhe ajo po katandiset si një trup pa pikën e gjakut. Produktet tona bujqësore, të pakta në sasi e të varfëra në kualitet, shiten për hiç gjë. Brenda nuk gjejnë asnjë përkrahje se shteti s'merr asnjë masë për të ndaluar çvleftësimin e tyre; jashtë nuk t'i zë njeri me dorë se nuk mund të konkurojnë me produkte të huaja.

Ky emigrim i brendshëm nuk mund të ndalohet me masa administrative. Autoritetet le të shkruajnë qarkore sa të duan, një proces që ka rrënjët në organizmën ekonomike të sëmure do të ndjekë rrugën e tij. Kur bujku vuan për bukë, kur ai nuk sheh asnjë perspektive përmirësimi, asnjë përkrahje serioze, asnjë fitim nga puna e tij, nuk mund t'a detyrosh të qëndrojë në katund. Ardhja në qytet mund të jetë më e keqe për të megjithatë ai do t'a provojë një herë fatin e tij kur s'ka se si rron në katund.

Kjo pesimizmë, kjo ftohtësi kundrejt punimit të tokës, kjo tendencë e rrezikshme për të gjetur derman në qytet e në arkën e shtetit, nuk luftohen me urdhëra prej së larti as me artikuj gazete. Bujkut nuk i bëjnë përshtypje thirrjet sentimentale, as yshtjet e thekshme. Ai është realist dhe bindet vetëm me fakte me prova konkrete. Mentaliteti i

ndryshkur, metodat primitive të punimit, ngadalësia proverbiale e bujkut nuk zhduken me fjalë e me shkrime, as edhe me ndonjë nga ato masa të përcepta që janë marrë gjer më sot. Plagët e bujqësisë sonë janë shkaktuar dhe vënë duke u keqësuar nga disa faktorë ekonomike e shoqërorë që na ka lënë e shkuara. Prandaj asnjë punë e saktë nuk mund të bëhet gjer sa nuk kapemi me largimin e këtyre ferrave që pengojnë çdo ecje përpara.

Bujku duhet të çlirohet nga kërpushët që i janë qepur mbas lëkurës dhe s'e lënë të marrë fuqi. Taksat që rëndojnë mbi prodhimin e tij të rritur me aq djersë e mundim duhen lehtësuar. Bujku duhet të gjejë interes në punën që bën, të gjejë aty për aty përfitimin material të mundimit që harxhon dhe sidomos të përmirësimin që sjell në punën e tij. Produkti që ai nxjerr në treg duhet të shitet, dhe me çmime të mira. Që të arrihet ky qëllim duhet ndërhyrja aktive e Shtetit. Duhet një politikë bujqësore e bazuar në kritere ekonomike e shkencore të shëndosha. Me fjalë të tjera duhen fonde dhe një plan veprimi që do të formulohet mbasi të studiohen çështjet me themel. Një pjesë e shëndoshë e buxhetit duhet të harxhohet për mëkëmbjen e bujqësisë. Duhet bërë kursime të forta në çdo dikaster tjetër për t'i siguruar fonde Ministrisë së Ekonomisë Kombëtare. Të gjitha klasat e shoqërisë duhet të skrifikojnë diçka për t'i dhënë pak shpirt bujkut tonë. Tërthorazi të gjithë do t'ia shohin dobinë kësaj sakrie, se me të lëvrire gjaku në organizmën ekonomike sot për sot të vdekur do të shtohen fuqitë prodhuese mbi të cilat bazohet krejt jeta e këtij shteti.

Shënim i redaksisë

Hallet e bujqësisë sonë, sot

"Hallet e bujqësisë sonë" i shkruar 80 vjet më parë dhe "Hallet e bujqësisë sonë, sot" janë pothuaj identike, duke filluar nga pjesëmarrja më tepër se sa minimale e të rinjëve në shkollat me profil bujqësor, tendencat e populla-

» vijon në fq. 12

Hallet e bujqësisë sonë, sot

» vijim nga fq. 11

tës për t'u larguar nga fshatrat që nuk prodhojnë asgjë, rendimentet e ulta të prodhimeve bujqësore, moskujdesi ekstrem i qeverisë ndaj këtij sektori jetik dhe bazë për ekonominë shqiptare. Tingëllojnë njëloj si 80 vjet më parë, hallet e bujkut tonë (i quajtur fermer edhe me një dy tokë), për mungesën e mjeteve bujqësore, për çmimet e larta të karburantit me të cilën punon tokën, për mbrojtjen e pakët që i bën shteti në çmimet e produkteve bujqësore e blektorale, për konkurimin e egër që i bën tregut prodhimi i huaj në perime, pemë frutore e të tjera produkte, deri te gruri e misri. Në moskontrollin e plehrave kimike e pesticideve apo edhe të farërave e fidanave që vijnë nga jashtë. Në çmimet e ulta me të cilat grumbullohen produktet blektorale e bujqësore si qumësht, mish, pemë frutore e perime. (A nuk kushton dy herë më shumë një litër ujë apo tre herë më shumë një shishe coca-cola se sa një litër qumësht)? A nuk është ministria e bujqësisë më e diskretitura e qeverisë në dhënien e fondeve, a nuk harxhohen më shumë fonde për konkurse bukurie, reklama, emisione e transmetime televizive? (Keni parë ju ndonjëherë në emisionet e lajmeve të këtyre viteve, se po mbillet e po korret bereqet, se po prodhohet qumësht e mish, se po ujiten e kullohen toka nga lagështira?

Me këtë gjendje ku është katandisur bujqësia, me këtë kujdes që tregon qeveria ndaj saj, si do të mësyjnë të rinjtë në shkolla profesionale të agrobiznesit, pyjores apo veterinarisë? Rreth 700 mijë ha tokë të punuar që ka Shqipëria (18 mijë Lezha), vetëm nga një klasë në çdo cikël ka në të gjithë Shqipërinë në Golem, Korçë e Fier që ndjekin shkollën e mirfilltë bujqësore. Me rreth një million ha pyje që ka vendi (18 mijë Lezha), vetëm një grusht nxënësish vazhdojnë shkollën e mesme teknike të pyjores në Shkoder. Po në këtë gjendje është edhe shkolla veterinare më me emër si ajo e Shkodres etj.

Ja mentalitetet, ashtu si para 80 viteve. Por këtë mentalitet e ushqen gjendja në të cilën ndodhemi, braktisja që i është bërë sektorit më jetik të ekonomisë së Shqipërisë. Bujqësia vazhdon të thotë: "E lumja unë çfarë dëgjoj, e mjera çfarë shoh..."

Rajonalizimi i bujqësisë: një hallkë që duhet vlerësuar



SKËNDER ULAJ
agronom në
Njësinë
Administrative
Balldre

Sektori i bujqësisë në Lezhë është aktualisht pjesa më e pazhvilluar e ekonomisë së Lezhës dhe vuan nga fragmentarizimi i thellë i sipërfaqes së tokës së punueshme. Vetëm në vitin 2010, qeveria vendosi subvencionimin e fermerëve të cilët mbjellin ullinj, agrume, drufrutorë dhe vreshta. Kjo masë është e domosdoshme, pasi vetëm në këtë mënyrë bujqësia shqiptare mund të arrijë të konkurrojë me sektorin bujqësor të vendeve fqinjë.

Rritja e prodhimit bujqësor, jo vetëm që zhvillon ekonominë dhe ul papunësinë, por mundëson uljen e çmimeve të produkteve kryesore jetike që konsumohen nga popullata, si dhe ul varësinë e vendit nga importet. Sipas të dhënave statistikore (shifrat e ministrisë së bujqësisë) prodhimi total nga bujqësia u rrit me vetëm 1.8% krahasuar me vitin e mëparshëm, normë kjo më e ulët se mesatarja vjetore e viteve të fundit (3.3%). Niveli i ulët i rritjes së prodhimit bujqësor, mund të shpjegohet me përmbytjet e mëdha në rrethin e Lezhës. Në shkallë republike, prodhimi bujqësor i papërpunuar vjen nga blegtoria (55%), ndërkohë që 30% vjen nga bimët e arave, dhe 15% nga pemëtaria. Në rrethin e Lezhës, gjatë viteve të fundit, vihet re një rritje e peshës së pemëtarisë, vreshtarisë, ullishteve, agrumeve etj, dhe ulje e peshës së prodhimit blegtoral.

Po të shikojmë në një plan më të gjerë, duke iu referuar Institutit European të Statistikave, 1/3 e plantacioneve të frutave dhe manaferrave të Europës e ka Spanja dhe po 1/3 e prodhimit european në këtë aspekt përballohet nga Spanja. Të tjerët nuk kanë tendencë të rriten as në sipërfaqe plantacionesh të frutave dhe as në volume për prodhimin e manaferrave, por përkundrazi kanë tendencë të ulen, duke lënë më shumë territor në këtë aspekt për Span-


jën. Nga ana tjetër, Polonia është lider european në prodhimin e mollëve. 32.6 % e tokës bujqësore të mbjellë me mollë në Bashkimin European e ka Polonia. Llogaritëni se sa më shumë se 32.6 është territori i Polonisë i mbjellë me mollë. Pra, duke i'u referuar një situatë të caktuar gjeografike, duke iu referuar një kompleksiteti kriteresh, bujqësia në Poloni është fokusuar në radhë të parë, tek molla dhe jo me idenë që të prodhojë çdo gjë për të mbetur pastaj mbrapa në gjithçka. Këto janë të dhëna që tregojnë se çfarë rëndësie ka rajonalizimi në bujqësi, si një instrument për të maksimizuar përfitimin. Po ashtu si një territor për të lehtësuar dhe nxitur specializimin në atë që çdo zonë mund të bëjë më mirë, me më pak shpenzime, për të përfituar më shumë të ardhura.

Rajonalizimi është po ashtu një strategji alternative menaxhimi toke. Ç'ka do të thotë se nëse në një territor të caktuar qeveria mbështetë vetëm mollën, atëherë vetvetiu në mënyrë të natyrshme fillon edhe një ndryshim i situatës së fragmentimit të tokës. Pasi, pa pasur nevojë të bashkohen në forma legale të komplikua, njerëzit bashkohen pikërisht tek investimi në të njëjtën kulturë. Kështu, i gjithë procesi sjell pastaj maksimizimin e përfitimit nga i njëjti territor, sado i fragmentuar të jetë ai. Po ashtu, rritja e eksporteve është një instrument që nxit krijimin e një marke prodhimi shqiptar edhe që, sigurisht e forcon fermerin shqiptar.

Po e mbyll me një frazë: "Fermerët duhet të zotërojnë minimumin e duhur të dijes mbi ekonominë, sipërmarrjen dhe duhet të kenë një vetëdije të lartë mjedisore për të përballuar sfidat e të ardhmes". Pa as më të voglin dyshim besojmë, bujqësia sot shumë më tepër se sa subvencion, në kuptimin e vjetër të fjalës, është investim në dije, në inovacion dhe për progres. Është një investim që, sigurisht jemi në të parët që duhet ta bëjmë, për t'i dhënë një cilësi të re strukturave tona në territor, për t'u kthyer Drejtoritë e Bujqësisë në struktura që dinë dhe përçojnë dije, në struktura që kanë informacion dhe përçojnë informacion, në struktura që janë mbështetje e fermerit për t'u orientuar në rrugët e komplikua të aplikimit dhe të realizimit të fondeve nga Bashkimi European dhe në struktura që janë ajka e kapitalit tonë njerëzor.

PSE NUK MBILLEN MË MBI 250 MIJË HA TOKË?

(Dhe pse prodhimi bujqësor është larg totalit të vitit 1990?)



ILLO FOTO
Publicist

“Një dallëndyshe bukuroshe që më freskoi gjykimin”. Kështu mund t’a quaj numrin e tretë të gazetës “Drini”, që më ndezi motorët e memories, për t’u kthyer në vite, tek arsyetimet e një zhvillimi bujqësor shqiptar, aq të dëshiruar në dekada. Paraardhësit e “Drinit” kanë bluar vetëm fjalë, këtu përfshijë dhe veten. Paraardhësit e “Drinit”, nuk arrinin t’i lexonin fermerët. “Drini” po e afirmon veten, në përpjekje konkrete, për të njohur realisht të tashmen dhe perspektivën. Ky edicion është me lëndë të spikatur, sepse e udhëheq fermerin drejt një pune shkencore, për të garantuar sukses të punës së lodhshme bujqësore dhe blegtorale. Dy pyetje i kanë munduar shqiptarët, qysh në vitet e para të këtij tranzicioni: Pse nuk mbillen më mbi 250 mijë ha tokë dhe pse prodhimi bujqësor është larg totalit të vitit 1990? Për gjëndjen bujqësore të vendit, ajo që dua të nënvizoj është fakti shumë i keq, që këto dy pyetje kanë po të njëjtin intensitet edhe sot. Kjo na trishton të gjithëve. Është bërë e qartë, se zhvillimi tërësor i bujqësisë, varet nga politikat bujqësore që zbaton shteti. Po qe se infrastruktura tërësore nuk funksionon, fermeri i është dorëzuar natyrës. Në këtë tranzicion ka dhe disa suksese në bujqësi. Toka në zonën kodrinore pothuajse selitet mirë, aty ku ka banorë. Sek-

tori i perimikulturës është zhvilluar mjaftueshëm. Ka përmirësime në pemtari. Ajo që është shumë e rëndësishme lidhet me masat efikase, që po merren në pylltari, pasi ky sektor pësoi dëme të rënda nga furia shkatërrimtare e tranzicionit. Ministria e mjedisit dhe specialistët e kësaj ministrie e kanë vënë gishtin në plagë. E njohën gjëndjen dhe po i kundërvihen me masa efikas. (Nuk di se si do të zbatohet memorandum i pyjeve?)

Ministria e bujqësisë as e ka zënë në gojë, se ka 25 % të tokës së kadastruar, djerrë. Ky është shqetësim i madh jo vetëm për fshatarësinë, por për gjithë kombin. Këshillat e “Drinit”-t janë receta, për ta kuruar sado pak këtë sëmundje, që po vuan zona fushore, prej më shumë se një çerekshekulli.

Zona kodrinore e Lezhës, që me sa di unë nuk është pak, e ka shumë më të thjeshtë integrimin ekonomik. T’u shërbesh bimëve dhe drurëve frutorë apo pyjorë, është punë aristokrate. Unë do t’u këshilloja banorëve të këtyre fshatrave të zhvillojnë, krahas pemtarisë edhe blegtorinë, kryesisht atë të imët, por duke mbarështuar raca të kultivuara. Nuk mund të konkurohet me racat primitive, që nuk shpërblejnë as punën ditore të krahut të punës.

Edhe në fushë blegtorica ka më shumë garanci, po të kemi parasysh, që ushqimet të sigurohen jashtë fazës së rezikuar të përmytjeve. Vështirësitë e blegtorisë kapërcehen më lehtë. Unë do të këshilloja rritjen gjerësisht të derrit, sepse soja dhe misri mund të realizohen, pa shumë rreziqe.

Kullota masive melifere e Kakariqit ka vetëm një në Ballkan dhe ai është në Lezhën e “Drinit”-t. Vë re se janë ngritur


dhe vijnë të ngrihen punishte mishi moderne, por mishin e bien nga Brazili. Të hulumtohet ky realitet dhe mund të vihet në rrugë të mbarë një linjë e rëndësishme e prodhimit të mishit të derrit, që t’i shesë derrat nga 1 kv. Disa ferma derash në Lezhë, mund të bëjnë përmbysje. Të mos harrojmë, se ish feramat mbanin kombinatin gjigand të mishit në Tiranë. Industria e derrit ende nuk ka filluar. Ka zhvillim industria përpunuese e mishit. Duhet një studim konkret bilateral. Ka disa mendime se misri për derra mund të blihet lirë në tregun e jashtëm. Varet nga rendimenti dhe e dyta, misri të jep dhe degën për lopën, pa llogaritur krahun familjar të punës. Po si mendojnë këta njerëz: Duhet të mos mbjellim misër, grurë dhe sojë, askund dhe askurrë? Nuk mund të ketë bujqësi pa misër, pa grurë dhe pa lopë. Të tjerat diskutohen, por nuk përjashtohen. Është vendi të përmend dhe një detaj: Industria përpunuese ushqimore duhet të jetë e fjalës së fundit, për të pasur garanci të daljes dora-dorës në eksport. Në tregun amerikan shoh, që hyjnë produkte bulmeti nga Europa, por të cilësisë extra. Ne, nuk ka pse të mos i arrijmë këto standarte që kanë arritur edhe popuj pa tradita.

Në zonën malore të Lezhës në rast se popullsia është rralluar, mendoj të nxiten sipërmarrës biznesmenë të apasionuar, të krijojnë korporata bujqësore-blegtorale dhe pyjore. Këto sipërmarrje mund të shtrihen në sipërfaqe të gjëra, ku përfshihen pyje, kullota, ujra, gurore, kamina dhe gjithçka, që mbulohet me emrin “resurs natyror”. Për pasuritë publike lidhen kontrata me shtetin, ndërsa pronat private merren me qira. Një sipërfaqe e tillë studjohet imtësisht nga specialistë të fushave dhe ky preventiv, pasi të pëlqehet nga sipërmarrësi, zhvillon veprimtarinë financiare. Këtë mënyre pune nuk e shpika unë, por zhvillohet në Amerikë, madje shtrihen në më shumë se në një shtet. Janë nën ndikimin e senatorëve dhe të guvernatorëve. Në disa korporata të mëdha zhvillohen veprimtari artizanale. Një prej tyre kishte dhe flotë peshkimi. Mendoj se mund të aplikohet në fshatrat e shpopulluara, që nuk di sa ka në Lezhë, por kam parë një reportazh të Marin Memës, ku tregoj se në disa fshatra malore kishin mbetur pak kuaj, që kishin kaluar në gjëndje të egër.



Bllloqe parcelash të mbjella me misër në Torovicë

EDHE PËR NJË PEMË TË VETME, PROJEKTUESI NDRYSHON DREJTIMIN E RRUGËS



SABIT ABDYLI
shkrimtar me
banim
në Zelandën e Re

Nga Aucklandi...

Në orët e para të mëngjesit, nga Aucklandi u nisëm për në cepin e mbarimit të Ishullit Verior. Katërqind e njëzetë e dy km rrugë deri në Cape Reinge me veturën golf, i kaluam për 5 orë e gjysmë. Me të arritur parkuam veturën dhe në këmbë zbritëm shtegut të shtruar poshtë vendit ku përfundon toka e Zelandës. Koha e mirë dhe turistë të shumtë. Impozante ishte pamja e takimit të detit Tasman në perëndim dhe oqeanit Paqësor në lindje... Edhe me sy vërehej vija ndarëse ku përplaseshin valet: herë qetë, herë me rrëmbim dhe më dukej se i thoshin njëra-tjetres: fqinjë jemi dhe secili zot në territorin e vet. Kanë dallime në ngjyrë dhe kjo vërehet me sy nga bregu.

Bëmë fotografi dhe kthehem rrugicës vende-vende thikë përpjetë në të dy anët ulëse për të pushuar. Në rrafsh-altën prej ku shihej gjithë rrugica gjarpërore dhe poshtë oqeani pafund, shtruam ushqimet që kishim me veti dhe në ambient që nuk mund të përshkruhet me fjalë drekuam.



-Për të mbrojtur drurët "Kauri" edhe rruga devijohet


...në kthim për Paihia.

Rrugës nuk ke si ta mbështetësh kokën e të dremitetësh, pa hapur sytë për të parë natyrën e mrekullueshme, djathtas e majtas. Herë Flutura, herë Agimi (fëmijët e mi) e drejtojnë makinën. Rrugëtim i gjatë. Natyra në Zelandë është si në përralla, nga ato më të bukurat. E ruajtur me fanatizëm, askund nuk sheh qoftë një bisht cigare, qese najloni, letër etj. Rrugës, pushimore e tualete të pastra, me ujë, sapun e letra higjienike brenda pa pagesë. Kështu është gjithandej kah shkon: plazheve, fushave sportive, qyteteve, pishinave, pikave turistike, parqeve etj. Pas tri orë rruge mbërrimë në qytetin Paihia, 60 km në veri të Whangarei ku kishim rezervuar hotelin. Dalim e i biem kryq e tërthor qytetit të bukur me veturë, ndalemi te plazhi i njohur i qytetit, vizitorë vendës e të huaj shijonin bukuritë e bregut.

Anglezë e maorë: "mashttrim" i shkruar

Vazhdojmë rrugën. Ndalemi te vendi Waitangi (shtëpia) ku u nënshkrua marrëveshja me 6 shkurt 1840 mes përfaqësuesit të mbretëreshës Viktoria të Britanisë së Madhe dhe përfaqësuesit të popullsisë vendëse (maorëve). Me këtë marrëveshje Anglia e mori nën ombrellën e vetë tokën që vendësit e quanin Aotearoa (Toka e reve të bardha e të gjata). Traktati (marrëveshja) i nënshkruar ka dallime në mes të versionit anglisht dhe përkthimit maorisht, dhe që nga viti 1840 edhe sot debatohet në lidhje me këtë mashttrim të anglezëve. Qysh me këtë rast, kryetari i shtetit është mbretëresha (mbreti) e Britanisë që e ushtron pushtetin nëpërmjet një guvernatori të emëruar prej saj/tij.

Nga këtu vizitojmë qytetin tjetër tërheqës në gjirin e ishujve të veriut, Kerikeri. Kalojmë çaste të bukura në parkun e qytetit mes të cilit kalonte lumi me ujët e kthjellët, plotë shpezë me një shtëpi të ndërtuar prej gurit, e ngjashme me kullat shqiptare, kuptohet pa frëngji e pika vrojtuese. Te Haruru Falls bëmë fotografi. U kënaqëm me pamjen e ujëvarës, stërpikave si shi i imët prapa të cilave krijohet "shoka" e ylberit. Për të parë sa më shumë rrugëtojmë drejt bre-



Druri gjigand, Kauri

gut perëndimor të Ishullit verior. Pamje mahnitëse. Fusha, male e kodra gjigante pafund. Toka të punuara pak, dominonin kullosat, në to kullosnin lopë racash të ndryshme, kuaj e dele.

Drurët "kauri" ndër më të mëdhenjtë në botë

Lëshohemi vendit të quajtur Waipoua ku dominojnë pyjet e ruajtura ashtu siç ishin në origjinën e tyre në Ishullin verior, me drurë "kauri", që tash janë në mbrojtje të shtetit. Rrugë me shumë kthesa dhe përgjatë saj pyjet e dendura anash, vetëm lart shihej një copë qielli. Edhe për një pemë të vetme, projektuesi i rrugës e ka ndryshuar drejtimin e saj. Por jo vetëm për një rrugë: asnjë projektues nuk guxon të projektojë për të ndërtuar në kurriz të ambjentit, askush nuk guxon të këmbëjë një pallat qoftë edhe me një pemë të vetme. Pema, pyjet, ato janë të parat.

Mbërrimë te njëri prej këtyre drurëve, ndër drurët më të mëdhenj në botë. Druri ka perimetrin 13.77 m, lartësia 17.68 m dhe në total lartësia me degë 51,2 m. Vëllimi 244.5 m³. Të gjithë këto të dhëna drurui i ka të shënuara në pasaportën tij. Rrugës hasëm edhe në drurë tjerë të këtij lloji, por jo në këtë madhësi. Në thellësi të pyllit rrinte roje ose bënte punën e ciceronit një femër, e cila fliste me pasion për pyllin, drurin, legjendat... Në terrin e parë të mbrëmjes, të lodhur dhe me mbresat nga më të mirat për ato që pamë në ambjentin dhe në natyrën e Ishullit verior të Zelandës së Re, mbërrimë në Auckland.

13 shtator 2016

KUSH ËSHTË MË I RËNDËSISHËM: KONTROLLI I MISHIT APO I UJIT TË PISHËM?

Në kushtet e tanishme, ndotja e ujit të pishëm është një ndër problemet më serioze në botë, por kjo "sëmundje" ka filluar të ndihet edhe në Shqipëri. Vendin tonë nuk mund ta konsiderosh më si "vend i virgjër" në këtë aspekt, si vend që ka ujëra të pastërta, të kthjellta e prej burimeve të pandotura. Zhvillimet apo ndërtimet pa kriter, urbanizimet pa ligje e rregulla, mosdisiplinimi i kanalizimeve të ujrave të zeza, dëmtimet në rrjetet e ndërtaura të ujësjellësive ekzistues, shpimet e shumta të puseve arteziane në zona të njohura që përmbajnë ujë të pishëm, dikur me cilësi etj, kanë bërë që pastërtia e ujit të ketë probleme edhe në Shqipëri apo referuar më afër, edhe në rrethin tonë.

Sipas studimeve, ndotja e ujit shkakton sëmundje dhe epidemi tek njerëzit, probleme mjedisore për ekosistemet, elementët futen në zinxhirin ushqimor, shkaktojnë zhdukjen e florës dhe faunës ujore. Në veçanti, banorët e rajoneve të varfëra të globit janë të ekspozuar ndaj sëmundjeve që vijnë nga ndotja e ujit. Sipas të dhënave statistikore të botuara edhe në vendin tonë prej institucioneve të specializuara që merren me studimin e tokës dhe të ujit, "nga uji i ndotur në mbarë botën vdesin më shumë se


14.000 njerëz në ditë dhe sëmuren disa herë më shumë nga sëmundjet epidemike. Vetëm në Indi vdesin mesatarisht 1000 fëmijë në ditë nga uji i ndotur. Në nivelin botëror vlerësohet se më shumë se 500 milionë njerëz pinë ujë të papërshtatshëm (të ndotur veçanërisht nga ujërat e zeza) dhe pasojat e para janë fëmijët. Më shumë se 250 milionë njerëz sëmuren nga sëmundje të shkaktuar nga uji i ndotur (tifo, diare, kolera)". Por prej epidemive të tilla nuk ka shpëtuar as vendi ynë, të cilat kanë si origjinë ndotjen e ujit të pishëm. Ka patur raste të kolerës, hepatitit A etj.

Po si është i organizuar sistemi i monitorimit të kontrollit të ujit të pishëm? Sa funksionojnë organizmat që mbrojnë konsumatorin? A ka institucione që përgjigjen për cilësinë e këtij produkti të pazëvendësueshëm, të përditshëm, pa të cilin jeta do të shuhej brenda një dite? Duhet thënë se nuk mungojnë ligjet, por si zakonisht në Shqipëri ato nuk zbatohen. Nuk mungojnë zyrat e specializuara, por si zakonisht në Shqipëri ato janë të mbivendosura në kompetenca dhe të paqartësura se deri ku kanë të drejtë apo detyrë për të kryer një funksion. Ka Autoritet Kombëtar të Ushqimit (AKU) me degët e veta nëpër rrethe e qarqe, që

kontrollon gjithshka, çdo ushqim, por uji nuk konsiderohet i tillë; ka zyra të mbrojtjes së konsumatorit në bashkitë e vendit që monitorojnë çdo gjë që konsumon apo i shërbehet njeriut, por uji çuditërisht nuk konsiderohet një produkt që konsumohet; ka polici bashkiake që monitoron deri edhe vendet e tregëtimit të fidanëve të perimeve, por jo se, ku mbushim e pijmë ujin; ka autoritete të tjera kombëtare e rajonale që trajtojnë basenet ujore, rezervat ujore të ujit të pishëm, por shumica e tyre më shumë interesohen se sa të ardhura u grumbulluan nga shitja e ujit të pishëm, por nuk trajtojnë cilësinë e ujit që konsumon në çdo ditë çdo njeri i gjallë.

Çdo ditë e çdo orë kontrollohen tregjet, së paku strukturat për këtë problem janë. Në mëngjesin e çdo dite kontrollohen thertoret ku theren kafshët e gjalla të vendit apo të importit. Ka ligj për këtë problem. Në çdo thertore duhet të jetë kontrollues një mjek veteriner, i cili lëshon raporte veterinarë për mishin, është apo jo i konsumueshëm. Bëhet mirë apo jo ky proces, është tjetër gjë, por dikush e ndjekë zbatimin e kësaj rregulloreje. Po për ujin e pijshëm, kush mendon? Mendoni, sa persona i drejtohen pikave të tregëtimit të mishit në ditë dhe sa është raporti i atyre që e blejnë mishin me ata që e prodhojnë vet nga një anë dhe sa njerëz konsumojnë ujin e pishëm çdo ditë, nga ana tjetër. Pra kemi një armatë të tërë kontrolluesish e inspektorësh për tregjet e mishit apo thertoret, ku konsumatorët janë shumë më të pakët dhe cilësia e mishit mund të vlerësohet edhe me "sy e hundë" dhe nuk kemi kontrollorë për ujin e pishëm të cilin e konsumon çdo njeri qysh sa lind e deri sa vdes dhe gjatë të gjithë 24 orëve. Vetëm një roje rezervuari i besohet klorifikimi i depove të ujit dhe një mjek i vetëm i qendrës së higjienës e epidemiologjisë pret brenda katër mureve të laboratorit t'i dërgojnë kampionet e analizave të ujit të pishëm për 130 mijë banorët e bashkisë së Lezhës.

M. SHABANI




Uji i pishëm duhet të kalojë nëpër këto pajisje laboratorike

KY NUMËR I "DRINIT" U MUNDËSUA NGA "FARMVET LEZHA" SH.P.K.

"FARMVET LEZHA" SH.P.K.

Farmvet Lezha SHPK është themeluar në vitin 2000 si person juridik me qendër në qytetin e Lezhës dhe me një filial në Tiranë. Aktiviteti kryesor është importimi dhe tregtimi i barnave veterinarë, vaksinave për shpendë dhe derra, dhe i materialeve për bletarinë. Farmvet Lezha shpk duke zotëruar eskuzivitetin e kompanive të huaja italiane, spanjolle, serbe dhe greke promovon dhe tregëton medikamente dhe produkte veterinarë në të gjithë Shqipërinë. Në sajë të një stafi të kualifikuar, shërbimit korrekt, shumë llojshmërisë së produkteve dhe shërbimeve, Farmvet Lezha shpk e ka shtrirë aktivitetin e saj tregëtar në të gjitha rrethet e vendit duke bashkëpunuar me 149 farmaci veterinarë dhe dyqane bletarie. Duhet të theksojmë se Farmvet Lezha shpk ka 96 medikamente të regjistruara për përdorim në vëndet e Komunitetit European dhe në Shqipëri. Gjithashtu Farmvet Lezha shpk çdo vit organizon seminare promovimi dhe azhornimi me pjesmarrjen e vetë relatorëve të firmave të huaja prodhuese si Invesa International, Fatro Group SA, Chemifarma SpA etj, dhe me një pjesmarrje të gjërë të veterinerëve të prodhimit, të fermerëve dhe institucioneve të bujqësisë (Fakulteti i Veterinarisë, Ministria e Bujqësisë, Instituti i Kërkimeve Veterinarë, Drejtoria e Bujqësisë së Rrethit Tiranë etj.) në Tiranë dhe në rrethet e tjera të Shqipërisë.

API HERB
Ushqim plotësues
me bazë ekstraktesh vegjetale, vajra esenciale,
vitamina të grupit B.




bustina 40 g (kuti me 10 bustina) bustina 500 g bustina 1000 g

MËNYRA E PËRDORIMIT (DOZË PËR 10 KOSHERE):
Shkrij 40g ApiHerb në 500 ml shërbet (ujë dhe sheqer në raportin 1:1).
Përsërite 3 herë me ritëm 1 javor.

KËSHILLA
Përgatiteni tretësirën 12 orë para përdorimit dhe ruajeni në vend të freskët, të thatë dhe pa dritë, deri në momentin e përdorimit.
Përdoreni tretësirën brenda 48 orësh.

PROVAT PRAKTIKE TË API HERB

Shtimi i popullatës së kolonisë së bletëve




RITJA MESATARE NË BLETËVE

+ 3.000 BLETË


P. Bellati, A. Chioce, G. Della Vedova, M. Novacchi

Ky studim i kryer në Friuli në pranverën e vitit 2012 demonstroi efektin pozitiv të Api Herb mbi zhvillimin e familjes. Kosheret e trajtuara kanë patur një shtim mesatar të popullatës të barabartë me 25% më shumë krahasuar me grupin e patrajtuar.



FARMVET

Lezha



Dr. Prengë PEPA
General Manager
FARMVET LEZHA Shpk

LEZHA

Lagja "Besëlidhja"
Lezha-Albania
Tel: 0692076316
Tel/Fax: 02153525
E-mail: ppepa@albmail.com

Ermal Pepa
Filial Manager
FARMVET LEZHA shpk
Rr. Reshat Petrela
Pranë Arkivës Shtetit
Tel: 0692066317

TIRANË

Dr. Tonin Shala
Import-Export Manager
Tel: 0694066319
Tel: 068299884
E-mail:
tonin_shala@hahoo.com